



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.35

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.25, datë 10.4.2006	Për disa ndryshime në përbërjen e komisioneve të përhershme Kuvendit.....	1127
Dekret nr.4827 datë 18.4.2006	Për ambasadori.....	lirim 1127
Dekret nr.4828 datë 18.4.2006	Për ambasadori.....	emërim 1128
Vendim i KM nr.209, datë 12.4.2006	Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror...	1128
Udhëzim i MASH nr.7, datë 18.4. 2006	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.144 datë 8.3.2006 “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollë në arsimin parauniversitar”.....	1132
Vendim i ERE-s nr.27, datë 20.4.2006	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për konsumatorët fundorë për periudhën 1 janar – 30 qershor 2006.....	1135
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Altin Muçaj....	1135

VENDIM
Nr.25, datë 10.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Gazmend Oketa zgjidhet anëtar i Komisionit për Çështje Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Deputeti Rahim Kaleci zgjidhet anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Deputeti Spartak Ngjela zgjidhet anëtar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Deputeti Fatos Beja zgjidhet Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.4827, datë 18.4.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Adhurim Resuli, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Kanada.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4828, datë 18.4.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Besnik Konçi, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Kanada.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM **Nr.209, datë 12.4.2006**

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR PRANIMIN E PERSONAVE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE PRIVATE, TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4 të nenit 20 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private, të përkujdesit shoqëror si më poshtë vijon:

KREU I

KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE NISMA PËR PRANIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE PRIVATE, TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

1. Kriteret për vendosjen e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror.

1. 1. Në institucionet e përkujdesit shoqëror pranohen fëmijët:

a) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit apo mbeten përkohësisht pa prindër, si dhe nuk kanë persona të tjerë të afërm që të marrin përsipër kujdestarinë ose birësimin e tyre;

b) e lindur jashtë martese e që, për rrethana të caktuara, nuk mund t’i rrisë nëna;

c) që vijnë nga familje, ku prindërve, të dyve ose njërit, u është hequr me vendim gjykatë të formës së prerë e drejta prindërore. Kur prindërit janë dënuar nga gjykata, me vendim të formës së prerë me heqje lirie, fëmijët e tyre vendosen në institucionet e përkujdesit shoqëror, për të gjithë periudhën kohore të vuajtjes së dënimit të prindërve, dhe kur gjykata është shprehur për vendosjen e tyre në institucionet e përkujdesit shoqëror;

ç) të deklaruar të braktisur nga gjykata e rrethit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

d) për të cilët gjykata, me vendim të formës së prerë, vendos që të sistemohen në institucionet e përkujdesit shoqëror, pavarësisht nga gjendja familjare;

dh) prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje ekonomike, të vërtetuar me dokumentet përkatëse, ta mbajnë fëmijën;

e) familjet e të cilëve janë në krizë të rëndë sociale, për shkak se prindërit janë të divorcuar ose janë rimartuar;

ë) prindërit e të cilëve shtrohen në spital ose dërgohen për kurim jashtë shtetit. Në këtë rast vendosja e fëmijës në institucionet e përkujdesit shoqëror bëhet deri sa njëri ose të dy prindërit të kenë lënë institucionet përkatëse.

1.2. Në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijës nuk pranohen fëmijë “distrofe” apo të paaftë edhe kur ata i plotësojnë kriteret e përmendura më sipër.

1.3. Mosha e pranueshme për t’u vendosur në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijës është nga 0-15 vjeç, e ndarë përkatësisht:

a) nga mosha 0-3 vjeç vendosen në shtëpinë e foshnjës;

b) nga mosha 3-6 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës, të moshës parashkollore;

c) nga mosha 6-15 vjeç vendosen në shtëpitë e fëmijës, të moshës shkollore;

Në rastet e jetimëve, fëmijët mbahen në këto institucione deri në moshën 18 vjeç.

1.4. Jetimët, të cilët kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe dëshirojnë të vazhdojnë arsimin e mesëm, duhet të vendosen në institucione, që kanë në sistemin e tyre konvikte.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për pranimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror përfshin:

a) Certifikatën e lindjes;

b) Fotografi, 2 copë;

c) Certifikatën familjare;

ç) Certifikatën e vdekjes së prindërve, kur prindërit nuk janë gjallë;

d) Vendimin e gjykatës për heqjen e së drejtës prindërore ose kopje të noterizuar të tij;

dh) Deklaratën e noterizuar të nënës ose, në pamundësi, të drejtorit të maternitetit, që vërteton braktisjen e fëmijës;

e) Epikrizën shëndetësore, kartelën mjekësore ose fotokopje të noterizuar, me të dhënat laboratorike dhe për vaksinimin;

ë) Analizën për SIDA-n dhe hepatitin;

f) Një dokumentacion për gjendjen shëndetësore të prindërve, nëse ata janë gjallë;

g) Procesverbalin e dorëzimit të fëmijës nga materniteti në shtëpinë e foshnjës;

gj) Procesverbalin dhe urdhrin e transferimit, në rastin e lëvizjes së tij nga njëri institucion në tjetrin, për shkak të moshës;

h) Certifikatën personale të gjendjes civile të prindërve;

i) Dokumentin e shkollës, që ka ndjekur;

j) Deklaratën noteriale për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit, për vendosjen e tij në institucion;

k) Vërtetimin për gjendjen social-ekonomike të familjes, të lëshuar nga administratori shoqëror;

l) Dokumentet e noterizuara të pronësisë së banesës, si dhe dokumente të tjera për të drejtat pasurore, kur fëmija është trashëgimtar i drejtpërdrejtë, për rastet kur prindërit kanë vdekur ose kur, me vendim gjykatë, u është hequr e drejta prindërore;

ll) Të dhëna nga komisariati i policisë, që mbulon territorin ku banon.

3. Nismën për dërgimin e fëmijës në institucionet e përkujdesit shoqëror e kanë:

a) prindërit;

b) kujdestari i fëmijës, kur prindërit kanë vdekur ose u është hequr e drejta prindërore, me vendim gjykatë;

c) policia;

ç) seksioni i ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, në nivel vendor;

d) institucioni shoqëror i shërbimeve të përkujdesit të mëparshëm, kur fëmija ka mbushur moshën përkatëse.

KREU II

KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE NISMA PËR PRANIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE PRIVATE, TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

1. Kriteret për pranimin e personave me aftësi të kufizuar në institucionet e përkujdesit shoqëror.

1.1 Në institucionet e përkujdesit shoqëror pranohen persona me aftësi të kufizuar:

- a) mendore;
- b) fizike;
- c) sensore.

1.2 Aftësia e kufizuar sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” përcaktohet me vendim të KMCAP-it.

1.3 Moshë për t’u pranuar në institucionet rezidenciale, për personat me aftësi të kufizuara, është nga 0-25 vjeç.

2. Dokumentacioni, që duhet plotësuar për pranimin e personave me aftësi të kufizuar në institucionet e përkujdesit shoqëror përfshin:

- a) Certifikatën e lindjes së personit;
- b) Certifikatën e gjendjes civile;
- c) Vendimin e komisionit mjekësor për përcaktimin e aftësisë së kufizuar;
- ç) Epikrizën shëndetësore;
- d) Fotografi të personit, (2 copë);
- dh) Vërtetimin e gjendjes ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar, të lëshuar nga seksioni përkatës i ndihmës dhe përkujdesit shoqëror;
- e) Kopjen e vendimit të këshillit bashkiak apo komunal për pranimin e personit, me aftësi të kufizuara, në institucion;
- ë) Kërkesën për sistemimin e personit në institucion;
- f) Dokumentin e shkollës që ka ndjekur personi;
- g) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit, për pranimin e personit në institucion.

3. Nismën për pranimin e personit me aftësi të kufizuar në institucionet e përkujdesit shoqëror e ka:

- a) prindi;
- b) kujdestari i caktuar me vendim gjykatë ose nga KMCAP-i;
- c) policia;
- ç) administratori shoqëror, në nivel vendor;
- d) seksioni i ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, në nivel vendor.

KREU III

KRITERET, DOKUMENTACIONI DHE NISMA PËR PRANIMIN E PERSONAVE TË MOSHUAR NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE PRIVATE, TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

1. Personat e moshuar, për t’u pranuar në institucionet e përkujdesit shoqëror, duhet të përmbushin këto kritere:

- a) Vijnë nga familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
- b) Vijnë nga familje në nevojë, të vlerësuara nga administratori shoqëror;
- c) Janë të vetmuar, të braktisur dhe pa të ardhura;
- ç) Kanë mbushur moshën për pension, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për t’u pranuar në institucionet e përkujdesit shoqëror për personat e moshuar përfshin:

- a) Kërkesën me shkrim nga vetë personi ose familja, nga të afërmit e tij apo administratori shoqëror i njësisë ku banon, me miratimin e personit të moshuar;
- b) Certifikatën e gjendjes civile;
- c) Certifikatën e gjendjes familjare;
- ç) Fotografi të personit, (2 copë);
- d) Raportin mjekësor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;
- dh) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore, nëse përfiton ose jo pension pleqërie apo ndonjë lloj tjetër pensioni;
- e) Vërtetimin e lëshuar nga administratori i njësisë së ndihmës dhe përkujdesit shoqëror për

gjendjen ekonomike të familjes së personit të moshuar.

3. Nismën për pranimin e personave të moshuar në institucionet e përkujdesit shoqëror e kanë:

- a) vetë personi;
- b) kujdestarët e personit;
- c) policia;
- c) seksioni i ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore.

KREU IV

PROCEDURAT PËR SISTEMIMIN E PERSONAVE NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR, PUBLIKE DHE PRIVATE

1. Personat kanë të drejtë të sistemohen në institucionet e përkujdesit shoqëror, për një periudhë 6-mujore, e cila mund të zgjatet deri në një vit nga data e bërjes së kërkesës së tyre.

2. Periudha e sistemimit të fëmijëve nga materniteti në shtëpinë e foshnjës është 15 ditë nga dita e lindjes së fëmijës, por mund të zgjatet në varësi të gjendjes shëndetësore të fëmijës.

3. Për fëmijët që sistemohen në institucionet rezidenciale, të cilët u përkasin familjeve me probleme sociale, pas një periudhe 5-vjeçare të qëndrimit të tyre në këto institucione, bëhet rivlerësimi i gjendjes shoqërore dhe ekonomike të familjeve të tyre nga administratorët e njësive të qeverisjes vendore. Gjendja e re shoqërore dhe ekonomike i njoftohet këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, i cili rishikon vendimin për qëndrimin e mëtejshëm ose jo të fëmijëve në institucion.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.510, datë 24.11.1997 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimin”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM

Nr.7, datë 18.4. 2006

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.144, DATË 8.3.2006 PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.144, datë 8.3.2006 “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore në arsimin parauniversitar”,

U D H Ë Z O J :

KREU 1

I. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

Bordi i Miratimit të Teksteve (BOMIT) i ngritur nga MASH-i merr vendimin të lejojë përdorimin e një teksti të caktuar në sistemin arsimor parauniversitar.

II. Bordi i Miratimit të Teksteve

1. Bordi:

- a) Njofton shtëpitë botuese për kohëzgjatjen e programeve lëndore.
- b) Zbaton procedura të marrjes në dorëzim dhe shqyrtimit të ofertave që ruajnë fshehtësinë dhe korrektësinë e vlerësimit.
- c) Shqyrton dokumentacionet vlerësuese për ofertat e një lloji teksti të paraqitura nga komisionet e vlerësimit të ngritura prej saj.
- d) Kërkon shpjegime nga këto komisione për vlerësimet e tyre në shqyrtimin e teksteve.
- e) Shqyrton standardet e cilësive fizike të teksteve.
- f) Vlerëson çmimin sipas standardeve të paracaktuara.
- g) Merr vendim për çdo ofertë.
- h) Verifikon për qarkullim kopjen e tekstit të shtypur, të miratuar më parë prej saj dhe jep certifikatën e lejes për qarkullimin e tij, në bazë të së cilës çdo kopje e tekstit pajiset me pullë certifikimi. Të gjitha këto rregullohen në kontratën midis botuesit dhe MASH-it për botimin dhe shitjen në shkollë të tekstit, e cila nënshkruhet pasi BOMIT-i ka miratuar tekstin. Tekstet pa pullë certifikimi nga MASH-i nuk lejohet të përdoren në shkollë.

2. Procedurat për miratimin e teksteve zhvillohen me shpalljen e kërkesës zyrtare për tekste nga MASH-i, si dhe çdo tre muaj për kërkesat nga botuesit.

3. Përkundër vendimit të BOMIT-it mund t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim nuk mund të pezullohet apo rrëzohet nga ndonjë organ administrativ, qoftë ky dhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

4. Miratimi i ribotimeve bëhet sipas të njëjtave procedura që zbatohen për tekstet e reja, por në këto raste, përmbajtja e tekstit vlerësohet e miratuar (shiko Paketën e Informacionit, kreu II).

5. MASH-i përcakton tirazhin e nevojshëm për secilin tekst, si dhe kërkesat e kushtet e miratimit.

6. Për vitin shkollor 2006-2007:

- a) Për tekstet e klasës së tretë dhe të shtatë të arsimit bazë dhe Abetaren e klasës së parë, BOMIT miraton për përdorim më shumë se një tekst.
- b) Tekstet, të cilat janë miratuar nga bordi i vitit shkollor 2005-2006 si "alternative", kalojnë për përdorim pas shqyrtimit nga BOMIT të cilësive të tyre fizike dhe të çmimit.
- c) Për klasën e dytë dhe të gjashtë të arsimit bazë do të përdoren tekstet tanimë të miratuara dhe që janë në përdorim. Botuesit mund t'i ribotojnë e t'i shesin këto tekste në tregun e lirë, përkundërt çmimit të caktuar në procesin e miratimit paraprak nga BOMIT-i.

d) Tekstet e tjera të arsimit bazë dhe të mesëm, të cilat janë përdorur gjatë vitit të kaluar shkollor, fitojnë të drejtën e ribotimit pas shqyrtimit nga BOMIT të cilësive të tyre fizike dhe të çmimit.

e) Përveç teksteve të klasës së parë (përfshirë Abetares), të dytë, të katërt, të pestë, të gjashtë dhe të tetë të arsimit bazë, shtëpitë botuese mund t'i paraqesin BOMIT-it për miratim tekste të reja. Këto tekste u nënshtrohen procedurave të miratimit të përshkruara në këtë udhëzim dhe në Paketën e Informacionit, kreu II, bashkëlidhur.

III. DORËZIMI DHE SHQYRTIMI I OFERTAVE

1. Dorëzimi i teksteve për miratim bëhet në datat dhe orën që cakton BOMIT-i nga secili pjesëmarrës veç e veç, sipas radhës së paraqitjes.

2. Dorëzimi i teksteve bëhet sipas udhëzimeve të dhëna në Paketën e Informacionit, kreu II.

3. BOMIT vlerëson tekstet e paraqitura nga botuesit për nga cilësia pedagogjiko-shkencore, të dhënat e cilësive fizike të tekstit dhe çmimi. Në përfundim, ato miratohen ose jo në përputhje me arritjen e standardeve të vëna.

4. Shtëpia botuese paraqet dhe dokumente kualifikimi që përshkruhen në Paketën e Informacionit, kreu II, bashkëngjitur, ku sqarohen edhe hollësitë e procesit të dorëzimit dhe ruajtjes së fshehtësisë.

IV. KOMISIONET E TEKSTEVE

1. Pranë BOMIT-it funksionojnë komisionet e teksteve (KOMT).
2. KOMT-et nuk marrin vendim për miratimin e lejit të teksteve për përdorim, po ndihmojnë BOMIT-in ta bëjë këtë.
3. Një KOMT shqyrton vetëm një tekst.
4. Krijohet grupi i komisionerëve (GRUK), me anëtarë të mundshëm të KOMT-ve për çdo lëndë dhe nivel shkollimi. GRUK-u caktohet nga BOMIT-i.
5. Një orë para fillimit të punës së shqyrtimit të teksteve të të njëjtit lloj, hidhet shorti për përzgjedhjen e KOMT-ve për secilin tekst të atij lloji, në praninë e anëtarëve të BOMIT-it.
6. Pas shortit, secili KOMT veçohet nga komunikimi me të tjerë dhe nis vlerësimin e përmbajtjes së tekstit sipas procedurave standarde vlerësuese. Komisionerët e të njëjtit KOMT e vlerësojnë tekstin dhe mbushin formularin përkatës veçmas njëri-tjetrit. Diskutimi i çështjeve të përbashkëta dhe mbushja e formularit të vlerësimit mesatar bëhen në prani të krejt anëtarëve të KOMT-it.
7. Në përfundim, KOMT-i i paraqet BOMIT-it dokumentacionin e vlerësimit të tekstit bashkë me sugjerime për përmirësime të tij. BOMIT-i thërret krejt KOMT-in në mbledhjen për miratimin e tekstit përkatës.

V. SHTEPIA BOTUESE

1. Çdo shtëpi botuese ka të drejtë të marrë pjesë pa ndonjë kufizim në tregun e teksteve, nëse e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk ka çështje të hapura me organet gjyqësore ose me prokurorinë. Pjesëmarrja e tyre në tregun e teksteve shkollore bëhet në përputhje me skemën e vendosur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave më sipër dhe që është shpjeguar në Paketën e Informacionit, bashkëlidhur.
2. Shtëpia botuese merr përsipër:
 - a) Marrëdhëniet me autorët;
 - b) Përgatitjen për shtyp të kopjes së parë;
 - c) Marrjen e porosive për tekste nga shkollat;
 - d) Shtypjen;
 - e) Transportin e teksteve deri në shkollë.
3. Në kopertinën e çdo kopje të tekstit, shënohet çmimi.
4. Shtëpia botuese është e detyruar të dërgojë për përzgjedhje nga një kopje të tekstit të saj të miratuar për përdorim, në çdo shkollë të Republikës së Shqipërisë që përdor këtë lloj teksti.
5. Kopjet e teksteve, që shtëpitë botuese u dërgojnë shkollave për përzgjedhje, do të blihen nga vetë shkollat.
6. Shtëpia botuese i dorëzon drejtorit të shkollës tekstet e porositura nga kjo shkollë të kjo shtëpi botuese.

KREU 2

I. KOMISIONET E PËRZGJEDHJES SË TEKSTEVE NË SHKOLLA

1. Në çdo shkollë, ngrihen Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve (KOPT) që përbëhen nga të gjithë mësuesit e shkollës që janë të asaj lënde. KOPT-et përzgjedhin, sipas lëndës, tekstin e certifikuar që do të përdoret në atë shkollë.
2. Drejtori i shkollës njofton me shkresë zyrtare MASH-in, ZA-në dhe DAR-in përkatës, si dhe shtëpinë botuese përkatëse për llojet dhe numrin e teksteve që ka përzgjedhur për secilin lloj.
3. Për rastet kur shkollat përdorin llogaritë buxhetore të DAR-ve ose ZA-ve përkatëse, ato i dërgojnë DAR-ve ose ZA-ve porositë për tekste dhe ato dhe lidhin kontratat e shitblerjes me shtëpitë botuese.
4. Veprimtaria e KOPT-ve përshkruhet në rregulloren përkatëse të miratuar nga MASH-i.

II. LIDHJA E KONTRATAVE TË SHITBLERJES ME BOTUESIT DHE PAGESAT

1. Brenda datës 30 qershor, porositësit e tekstit (sipas rastit, drejtoritë e shkollave, DAR-i, ose ZA-ja) duhet të bëjnë porositë te botuesi nëpërmjet kërkesës për furnizim dhe të lidhin kontratën e shitblerjes me botuesin furnizues për furnizim në sasinë e kërkuar.
2. Porositësit duhet të nënshkruajnë faturën tatimore në adresë të botuesit furnizues me marrjen në dorëzim të teksteve në përputhje me kontratën e shitblerjes.
3. Porositësit nuk kanë të drejtë të zvogëlojnë sasinë e teksteve të porositura pas nënshkrimit

të kontratës së shitblerjes, por në këtë kontratë mund të parashikohet rikthimi i një numri të pranueshëm kopjesh të pashitura.

4. Drejtoritë e shkollave, DAR-et ose ZA-të të kenë të gatshëm personelin e autorizuar për aktin e pranimi dhe marrjes në dorëzim të teksteve, si dhe për të nënshkruar faturën tatimore në periudhën 10 - 30 gusht.

5. Drejtoritë e shkollave, DAR-et ose ZA-të janë të detyruara të likuidojnë në llogarinë e botuesit vlerën e teksteve të livruara për llogari të tyre, në përputhje me kontratën e shitblerjes brenda datës jo më vonë se 15 tetor 2006.

6. Hapin llogari rrjedhëse të vetën shkollat që janë në juridiksionin e bashkisë-qendër ose komunës-qendër. Për shkollat e tjera përdoren llogaritë rrjedhëse të ZA-së që i ka në juridiksionin e vet.

7. Shkollat që janë në juridiksionin e bashkisë-qendër ose komunës-qendër do të përdorin llogaritë buxhetore të tyre për kryerjen e veprimeve me shtëpitë botuese. Shkollat e tjera përdorin llogaritë buxhetore të ZA-së që i ka në juridiksionin e vet.

8. MASH kalon në llogarinë rrjedhëse përkatëse pjesën e subvencionit për tekstet, që i takon secilës shkollë.

9. Për tekstet e pasubvencionuara ose pjesërisht të subvencionuara, nxënësit paguajnë diferencën e çmimit pranë shkollave. Kjo diferencë derdhet në llogarinë rrjedhëse përkatëse për t'u transferuar në llogarinë rrjedhëse të shtëpisë botuese me të cilën është lidhur kontrata e shitblerjes.

10. Tekstet që shtëpitë botuese dërgojnë në shkolla për t'ua paraqitur KOPT-ve do të përfshihen në kontratën e shitblerjes ose u paguhen botuesve me urdhërpagesë të veçantë nga shkolla ose ZA-ja përkatëse, nëse teksti nuk përzgjidhet.

11. Drejtori i shkollës:

a) Firmos aktin e pranimi dhe marrjes në dorëzim të teksteve nga shtëpia botuese të shkolla, sipas sasisë së porositur dhe kushteve teknike të parashikuara dhe dërgon nga një kopje të tij në drejtorinë ekonomike të MASH-it, në ZA-në dhe në DAR-in përkatës.

b) Përgjigjet për marrjen në dorëzim të teksteve, ruajtjen dhe shpërndarjen e tyre, si dhe grumbullimin e parave nga nxënësit, sipas pikës 6 të kreut 2.

c) Dërgon shumën e këtyre parave në llogarinë buxhetore të shkollës ose të ZA-së përkatëse dhe urdhëron transfertën për pagesën e botuesit kur shkolla vetë ka llogarinë e saj buxhetore.

12. Tekstet e blera 100% me subvencionet shtetërore, me përjashtim të atyre të klasës së parë të arsimit bazë, janë pronë e shkollës dhe nxënësve u jepen në përdorim.

13. Prindi mund të blejë në librari tekste të papërdorura, por në këto raste, teksti nuk i subvencionohet blerësit.

III. RREGULLI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Punonjësi i MASH-it, i një DAR-i, ZA-je, drejtori ose zëvendësdrejtori i shkollës nuk mund të jenë njëherësh edhe autorë teksti ose pjesë e shtëpisë botuese pjesëmarrëse në sistemin konkurrues të tregut të teksteve shkollore. Autori i një teksti shkollor punonjës si më sipër, teksti i të cilit fillimisht ndodh të jetë i vetëm në tregun e përzgjedhjes nga shkollat, d.m.th. të mos ketë tekst alternativ konkurrent, i nënshtrohet automatikisht rregullit të konfliktit të interesit që nga çasti kur teksti i tij nuk është më i tillë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

VENDIM
Nr.27, datë 20.4.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGISË
ELEKTRIKE NGA KESH SHA, PËR KONSUMATORËT FUNDORË PËR PERIUdhËN
1 JANAR – 30 QERSHOR 2006**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b, 9 dhe pika 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 112, pika 2, germa a, të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) në mbledhjen e tij të datës 20.4.2006, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria KESH sh.a., për miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a., për konsumatorët fundorë për periudhën 1 janar – 1 korrik 2006, si dhe vlerësoi kërkesën nr.1061, prot, datë 14.4.2006, të Kryeministrit, duke marrë në konsideratë edhe kohën që kërkohet për një rivlerësim të propozimit të KESH sh.a., në përputhje me politikën e qeverisë për konsumatorët parësorë dhe mundësinë e rivlerësimit të subvencionimit të një kategorie konsumatorësh,

VENDOSI:

1. KESH sh.a., për konsumatorët fundorë për periudhën 1 janar - 30 qershor 2006, të aplikojë çmimet e përcaktuara sipas vendimit nr.55, datë 2.12.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

KËRKESË

Shtetasi Ilir Muçaj, lindur dhe banues në Patos të rrethit Fier, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Altin Muçajt i datëlindjes 29.12.1974, lindur në Patos të rrethit Fier.

Kërkues
Ilir Muça

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 21.4.2006
Doli nga shtypi më 26.4.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 100 lekë